



DREJTORIJA PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM

05-Nr. 313-615 /2018.

Klinë dt: 06/02/2018

Në Mbeshtetje të Ligjit Për Vetqeverisjen Lokale në Kosovë nr.03/L-040, nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës, Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim i KK të Klinës lëshon këtë:

N J O F T I M

Njoftohen Qytetarët e Komunës së Klinës, respektivisht të gjitha bizneset që operojnë në Komunën e Klinës, që të lajmrohen në zyret e drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit të KK të Klinës për ofrimin e adresave elektronike të bizneseve të tyre.

Drejtorija e Financave, ekonomisë dhe Zhvillimit e KK të Klinës, në koordinim me institucionet Qendrore dhe me donator të ndryshëm, i është qasur iniciativës që bizneset që operojnë në Komunën tonë, të konkurrojnë në programet e zhvillimit dhe të kenë mundësi të qasjes të përfitimit të donacioneve të ndryshme qoftë nga niveli qendror dhe donatorët e ndryshëm brenda dhe jashtë vendit.

Arsyeshmeria e këtijë njoftimi qendron në faktin se nëse Komunës i ofrohen donator të tillë, të jemi të gatshëm për ofrimin e sakt të shenimeve adekuate për konkurrencë në këtë drejtim.

Andaj të nderuar perfaqësues të bizneseve mos hezitoni, por lajmrohuni në drejtorinë përkatëse, për ofrimin e adresave dhe email--adresave të bizneseve tuaja.

Ju njoftojmë se këto shenime mundë ti dergoni qoftë si kopje fizike apo mes email adresave siq vijon:

- Aziz.Desku@rks-gov.net, telefoni nr.049-292-921, dhe
- Ajet.sejdiu@rks-gov.net, telefoni nr.049-920-650.

Me respekt.



Drejtori,

Aziz Desku

